

Analiza & Komentë

Rregullatorët në Kosovë: Sa të pavarur dhe llogaridhënës?

Në çdo demokraci pavarësia e autoriteteve, institucioneve rregullative apo rregullatorëve është parakusht për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj publikut për një çmim të arsyeshëm. Në rast se këto institucione i parashtrohen ndikimit politik, atëherë performanca dhe qëndrueshmëria e tyre vihet në pikëpyetje. Në rastin e Kosovës ndikimi politik ka qenë i shprehur në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve. Në Raportin e Progresit (2016) Komisioni Evropian ka qenë mjaft kritik ndaj procesit të ngadaltë dhe të politizuar për konsolidimin e bordeve.

Në shumë vlerësime hulumtuese është raportuar që Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infra-strukturë, Tregti dhe Industri (KZHEITI) është i kufizuar në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të cilët shkojnë si pjesë e një liste të propozuar nga Qeveria. Kjo do të thotë që procesi i konsolidimit të bordeve nuk garanton konkurrencë të mirëfilltë dhe transparencë të plotë. E tëra kjo jep përshtypjen që partitë politike shfrytëzojnë fuqitë e tyre në përzgjedhjen e bordeve që u përshtaten preferencave politike. Andaj, nuk është e çuditshme pse anëtarët

Si duhet vepruar tutje për ndryshimin e gjendjes aktuale mbetet të jetë ende një fjalëkryq. Çështja e shkarkimit të bordeve/drejtorive në raste kur rregullatorët bëjnë ndonjë shkelje apo nuk performojnë mirë ka nxitur reagime që një iniciativë e tillë mund ta cenojë vetë pavarësinë e rregullatorëve! Atëherë cila është alternativa më e mirë politike? Zgjidhja më e mirë për t'i pavarësuar dhe për t'i funksionalizuar rregullatorët në Kosovë është ngritja e kriterëve profesionale në nivelin e bordeve/drejtorive. Në këtë drejtim Kuvendi i Kosovës në vitin e kaluar ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit me Ambasadën Britanike. Qëllimi i kësaj iniciative është krijimi i pozitave drejtuese sa më të pavarura dhe profesionale me ndihmën e partnerit realizues të Ambasadës në cilësinë e këshilluesit dhe mentorit.

Është herët për ta gjykuar nivelin e progresit të kësaj iniciative, pasi deri më tani asnjë proces i rekrutimit dhe përzgjedhjes së rregullatorëve nuk është bërë sipas termave të kësaj marrëveshjeje (Zyra e Rregullatorit të Energjisë është ende në fazën e përmbylljes së këtij procesi dhe ende nuk mund të gjykohej se

Visar Sutaj

Sallonet e së martës janë një risimë javore e institutit "Demokraci për Zhvillim" (D4D-ja). Salloni ka format gjysmëformal, sipas rregullës "Chatham House" dhe pa prani të mediejeve. Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë politikane e publicistë për të reflektuar dhe për të kërkuar konsensus mbi temat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në kanalën e salloneve në "YouTube". Secili Sallon përcillet me editorial që publikohet në "Zëri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-së. Podcastet bazuar në editorial mund t'i

e bordeve në shumicën e rasteve nuk i përmbushin kriteret profesionale.

Për shumë vite shumica e rregullatorëve kanë qenë jofunksionale me borde të pakompletuara! Si rezultat këto institucione kanë qenë joefektive në procesin e vendimmarrjes për t'i rregulluar dhe për t'i mbrojtur tregjet apo industritë përkatëse. Derisa Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK-ja) mezi që ka funksionuar për më shumë se tre vjet, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH-ja) vazhdon të jetë i mangët në kapacitetet njerëzore dhe financiare për ta mbështetur ofrimin e një infrastrukture më të pasur hekurudhore ... E kështu me radhë, pasi që tregime të tilla janë të ngjashme tek shumica e rregullatorëve në Kosovë.

Se sa rregullatorët në Kosovë duhet dhënë llogaridhënie ende mbetet temë diskutimi. Sipas ligjit, rregullatorët duhet t'i raportojnë çdo vit Kuvendit të Kosovës. Kjo në praktikë nuk ndodh ashtu siç duhet, pasi në shumicën e rasteve raportet vjetore pranohen me vonesë dhe aprovohen pa ndonjë diskutim në përmbajtje. Në të njëjtën kohë deputetët kanë mangësi të njohurive teknike për ta vlerësuar punën e rregullatorëve, ashtu siç raportohet, dhe nuk arrijnë të reagojnë në mënyrë profesionale dhe të ofrojnë kontribut se si duhet përmirësuar puna e tyre. Kështu që rregullatorët vazhdojnë të punojnë me performancë të dobët, duke mos i dhënë llogari të mjaftueshme Kuvendit.

si kanë shkuar vlerësimet). Sido që të jetë, kjo iniciativë është tregues pozitiv për reformimin e sektorit rregullativ, me shpresën që partitë politike arrijnë ta kuptojnë rëndësinë e rregullatorëve dhe si ata duhet ushtruar rolin e tyre në mënyrë të pavarur për të mirën e gjerë publike.

Përgjithësia kryesore për t'i tejkaluar këto sfida prapë mbetet në Kuvendin e Kosovës, i cili duhet të jetë më i kujdesshëm në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve. Kjo kërkon që legjislativi ta krijojë një protokoll të rekrutimit, si dhe një sistem përcjellës për përzgjedhjen e anëtarëve me kualifikime profesionale, proces i cili duhet të jetë më mirë i rregulluar dhe më transparent. Me borde sa më profesionale dhe me integritet të lartë performanca e rregullatorëve do të përmirësohet. Në këtë mënyrë Kuvendi i Kosovës do ta ketë më lehtë të kërkojë llogaridhënie, duke mos cenuar pavarësinë e këtyre institucioneve. Kjo në të njëjtën kohë kërkon që Kuvendi të përcaktojë kriteret më specifike të vlerësimit të raporteve vjetore të rregullatorëve, në mënyrë që të sigurojë që rekomandimet të përfillen në të ardhmen. Dhe, në raste kur rregullatorët performojnë më mirë, Kuvendi duhet t'i mbështesë më shumë nevojat e tyre, sidomos gjatë procesit të buxhetimit për t'u siguruar që këto institucione të kenë resurse të mjaftueshme financiare për ta ushtruar funksionin e tyre.

gjeni në uebfaqen
tonë. Salioni i radhës
do të mbahet sot, më
3 tetor 2017, nga ora
16:45 në "Dit e Nat"
me temën: "Trans-
parenca dhe llogari-
dhënia e Këshillit
Drejtues të Univer-
sitetit të Prishtinës"